



GREENBRIDGE - Programi i Lëndës

Kursi mbi Aftësitë e Gjelbra - 1.1 Hyrje në Qëndrueshmëri dhe Etikë Mjedisore

Përshkrimi i përgjithshëm i kursit

Ky kurs synon t'u japë mësimdhënësve të arsimit profesional njohuritë dhe mjetet pedagogjike për të integruar konceptet e qëndrueshmërisë dhe etikës mjedisore në procesin mësimor. Qëndrueshmëria trajtohet jo vetëm si një kompetencë teknike, por edhe si një përgjegjësi morale, thelbësore për përgatitjen e nxënësve për shoqëri të qëndrueshme dhe tregje pune të së ardhmes. Kursi përfshin edhe temën e ekonomisë qarkore, duke e lidhur atë me qëndrueshmërinë dhe zhvillimet aktuale të tregut të punës.

Kursi i përgjigjet drejtpërdrejt nevojës së identifikuar për rritjen e ndërgjegjësimit mbi aftësitë e gjelbra të nxënësve të arsimit profesional në Kosovë dhe në Bosnjë e Hercegovinë. Duke fuqizuar mësimdhënësit të integrojnë qëndrueshmërinë në të gjitha lëndët, kursi synon të nxisë ndërgjegjësimin etik, ndryshimin e sjelljes dhe zbatimin e praktikave të qëndrueshme në kontekste profesionale.

Rezultatet e të nxënësve

Në përfundim të këtij kursi, mësimdhënësit e arsimit profesional do të jenë në gjendje të:

1. Kuptojnë konceptin e qëndrueshmërisë dhe rëndësinë e saj në arsimin profesional dhe tregun e punës.
2. Shpjegojnë parimet e etikës mjedisore dhe t'i përkthejnë ato në mësimdhënie praktike.
3. Integrojnë konceptet e qëndrueshmërisë në kurrikulat e lëndëve të tyre në mënyra të qarta dhe të zbatueshme.
4. Zbatojnë metoda mësimore interaktive dhe të orientuara drejt nxënësve për të nxitur reflektimin, ndërgjegjësimin dhe veprimin.
5. Përdorin burime dhe mjete didaktike që rrisin aftësinë e nxënësve për të adoptuar praktika të qëndrueshme.



Struktura dhe përmbajtja e kursit

Moduli 1: Bazat e qëndrueshmërisë

Ky modul synon të ndërtojë një kuptim të qartë mbi konceptet themelore të qëndrueshmërisë dhe rëndësinë e tyre në arsimin profesional. Ai prezanton tre shtyllat e qëndrueshmërisë (mjedisore, sociale dhe ekonomike), si dhe kornizat globale si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (SDGs), duke theksuar rolin e tyre në arsimin profesional, tregun e punës dhe kërkesën në rritje të punëdhënësve për praktika të qëndrueshme.

Moduli trajton gjithashtu ekonominë qarkore si nxitës kyç të inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke sjellë shembuj konkretë të praktikave të mira nëpër kompani.

Nënkapitujt:

- 1.1 Hyrje në qëndrueshmëri dhe zhvillim të qëndrueshëm
- 1.2 Lidhja mes qëndrueshmërisë, ekonomisë qarkore dhe Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- 1.3 Shembuj të praktikave të mira të qëndrueshmërisë në kompani

Moduli 2: Etika mjedisore - parime dhe praktika

Ky modul prezanton konceptin e Etikës Mjedisore dhe parimet e saj kryesore si qëndrueshmëria, drejtësia, përgjegjësia mjedisore dhe vlera e brendshme e natyrës përtej nevojave njerëzore.

Mësimdhënësit do të njihen me praktikën, veprimet, politikat dhe zgjedhjet e stilit të jetesës që pasqyrojnë etikën mjedisore. Në fund të modulit përfshihet një përmbledhje me shembuj nga jeta reale mbi integrimin e parimeve etike në praktikë.

Nënkapitujt:

- 2.1 Hyrje në etikën mjedisore dhe parimet kyçe
- 2.2 Praktikën e etikës mjedisore – veprime, politika dhe stil jetese
- 2.3 Shembuj të integritit të etikës mjedisore në organizata dhe komunitet

Moduli 3: Edukimi për qëndrueshmëri dhe etikë mjedisore - pedagogji dhe praktikë

Ky modul u ofron mësimdhënësve mjete praktike për të dhënë mësim në mënyra sa më të angazhuara dhe efektive.



Nënkapitujt:

3.1 Mësimi aktiv për qëndrueshmëri dhe etikë mjedisore

Prezantohen aktivitete si mësimi përmes projekteve, detyrat e zgjidhjes së problemeve dhe simulimet.

3.2 Mjetet vizuale dhe digjitale në mësimdhënien e qëndrueshmërisë

Fokus te përdorimi i videove, infografikave, tureve virtuale dhe aplikacioneve për të shpjeguar koncepte komplekse.

3.3 Projektet e udhëhequra nga nxënësit dhe planet e veprimit

Nxit mësimdhënësit të dizajnojnë detyra ku nxënësit identifikojnë një problem të qëndrueshmërisë ose etikës mjedisore në sektorin e tyre dhe propozojnë zgjidhje.

Aktivitetet mësimore

- Mësim i pavarur online me materiale të ofruara (tekst, imazhe, video të gjeneruara me vegla nga Inteligjenca Aritificiale)
- Sesione me ligjëruesin për prezantimin e përmbajtjes së re
- Diskutime gjatë sesioneve të trajnimit.

Orari dhe kohëzgjatja e kursit

Moduli	Sesioni me ligjërues (fizik/online)	Mësimi i pavarur
Moduli 1	1 orë	30 min
Moduli 2	1 orë	30 min
Moduli 3	1 orë	30 min
Totali	3 orë	1 orë e 30 min

Metodat e vlerësimit

- Për secilin modul ofrohet një pyetësor vetëvlerësimi me pyetje me nga vetëm një përgjigje.